

**KOMPANIA E UJËSJELLËSIT RAJONAL
SH.A.**



Njësia Operative Pejë
Rr. Gazmend Zajmi 5 30000 Pejë-Kosovë
Telefoni: +381 (0)39 432 694
www.hidrodrini.com

Menaxhimi i depove dhe O&M

Tabela e përmbajtjes

1. Parathënie	1
2. Objektiva e detyrës.....	1
3. Kohëzgjatja dhe rezultatet e detyrës.....	2
4.1 Në përgjithësi	3
4.2 Procedurat e tanishme të Depos	3
4.3 Programi kompjuterik i cili përdoret tani.....	4
4.4 Rekomandimet.....	5
5. Situata ekzistuese në lidhje me O&M Teknike në Njësitë Operative.....	6
5.1 Operimi Teknik.....	6
5.2 Mirëmbajtja	6
5.3 Rekomandimet.....	6
6. Prezantimi.....	7
7. Aktivitetet për detyrën e ardhshme.....	7

Lista e shtojcave

Shtojca 1	Termet e referimit
Shtojca 2	Një shembull i Formularit për Kërkesë të Materialit
Shtojca 3	Një grafikon që tregon se si duket Baza e të të dhënave të Depos e programit Piano
Shtojca 4	Një shembull i Formularit të Mirëmbajtjes që përdoret në Njësinë e Deçanit
Shtojca 5	Një shembull i Formularit të Mirëmbajtjes në Deçan – i përmirësuar

1. Parathënie

Prapavija

Duke u bazuar në performancën e varfër ekonomike të Ndërmarrjeve në Pronësi Publike (NPP), Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) orvatet që të ndryshojë këtë përmes Strategjisë së saj 2002/12 mbi konsolidimin e ndërmarrjeve të vogla të ujit dhe të mbeturinave në njësi të veçanta për ujë dhe për mbeturina. Në rajonin e Pejës, ndërmarrjet e Pejës, Deçanit dhe Klinës janë konsoliduar që në Tetor të vitit 2004 në Kompaninë Rajonale të Ujësjetës Hidrodrini, Pejë. Në vitin 2006 Kompania u zgjerua me anë të korporatizimit të ndërmarrjeve të Junikut dhe Istogut.

Projekti i Bashkëpunimit Teknik mbështetë Kompaninë Rajonale të Pejës dhe njësitë e veta operative në fushat e vlerësimit të mjeteve themelore dhe të blockmappingut (regjistrimit të lidhjeve dhe rrjetit si dhe krijimit të hartave digjitale). Përmes mbështetjes së projektit, me futjen në përdorim të MIS (në gjuhën Shqipe, Sistemit për Menaxhimin e Informatave) dhe në transferimin e të të dhënave aktuale financiare në një sistem kontabiliteti auditiv, kompania rajonale e ujësjetës do të jetë në pozitë që të përmirësojë bazën e vet për vendimmarrje. Për më tepër, ndër të tjera, do të futet në përdorim një strukturë e pagave e bazuar në performancë, në mënyrë që të promovohet (nxitet) motivimi dhe si rezultat të përmirësohet performanca e personelit të ndërmarrjes. Me anë të trajnimit në vend të punës (trajnim praktik), kompania rajonale përfiton mbështetje në themelimin e qendrave të konsumatorëve dhe futjen në përdorim të kërkimit të borxheve nga pagesit e këqij. Për më shumë, kompania pranon mbështetje në themelimin e depos rajonale si dhe gjithashtu mbështetje në menaxhimin e depos përfshirë këtu edhe futjen në përdorim të një programi adekuat kompjuterik. Të dhënat e konsumatorëve të cilat janë mbledhur deri më tani në kuadër të projektit (me anë të blockmapping-ut dhe bazës së të dhënave të konsumatorëve) duhet të transferohen në GIS (në gjuhën Shqipe, Sistemi i Informatave Gjeografike) i cili do të përdoret veçanërisht për zvogëlimin e humbjeve të ujit. Në këtë pikëpamje, para së gjithash, duhet të identifikohet dhe futet në përdorim një sistem adekuat i GIS-it dhe personeli përkatës duhet të trajnohet në përdorimin tij.

Mbështetja e projektit synon që t'i mundësojë kompanisë që të rritë efikasitetin e vet operativ dhe t'i mbulojë shpenzimet operative dhe më vonë të arrijë mbulimin e plotë të shpenzimeve. Për më tepër, kjo do të mundësojë zgjerimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe atij të kanalizimit gjë e cila do të çojë drejt një sigurimi të besueshëm të furnizimit me ujë për tërë popullatën e rajonit. Kompania rajonale e ujësjetës është përgatitur që të transformohet në një entitet të ligjshëm të furnizimit me ujë dhe menaxhimin e ujërave të zeza në rajon.

2. Objektiva e detyrës

Objektiva kryesore e detyrës së Ekspertit Afat-Shkurtër (EASH) për formën ndërkombëtare të Operimit të Depos dhe Mirëmbajtjes (O&M) ishte që të harmonizojë dhe të standardizojë procedurat ekzistuese të menaxhimit të depos si dhe futjen në aplikim të mekanizmave teknik të operimit dhe të mirëmbajtjes në Hidrodrini.

3. Kohëzgjatja dhe rezultatet e detyrës

Detyra e parë e EASH-së u zbatua në periudhën ndërmjet 26.02.2007 deri më 16.03.2007 në Njësitë Operative: Pejë, Deçan, Klinë, Junik, dhe Istog – Kosovë. Detyra e dytë është paraparë që të kryhet në mesin e vitit 2007.

Nga termet e referimit (shihni Shtojcën 1) kërkohen këto rezultate kryesore:

Depoja

- Vlerësimi i depove ekzistuese në Kompaninë rajonale Hidrodrini me pesë Njësitë e saj,
- Analizimin e procedurave të depos nëpër të gjitha Njësitë,
- Standardizimin dhe përmirësimin e procedurave të depos,
- Themelimin e depos rajonale.
- Përzgjedhja dhe zbatimi i një programi kompjuterik për menaxhimin e depos,
- Trajnimi i personelit rreth aplikimit të procedurave të standardizuara të depos dhe të programit kompjuterik.

Operimi dhe Mirëmbajtja

- Mbledhja dhe analizimi i procedurave ekzistuese të operimit dhe të mirëmbajtjes,
- Standardizimi, përmirësimi i procedurave të operimit dhe të mirëmbajtjes,
- Themelimi i një baze të të dhënave të mirëmbajtjes.

Kapitujt në vazhdim paraqesin një pasqyrim rreth të gjeturave dhe rekomandimeve të EASH.

4. Situata ekzistuese për sa i përket Depove në Njësitë Operative

4.1 Në përgjithësi


Fillimisht, EASH ka analizuar Raportin e Misionit për Depot dhe Menaxhimin e Materialeve të përgatitur (në Mars 2006) nga ana e Programit V të Rehabilitimit të Furnizimit Urban me Ujë (Urban Water Supply Rehabilitation Programme V), të financuar nga KfW. Ky raport përfshinë të gjeturat dhe rekomandimet për Njësitë e Hidrodrinit në Pejë, Deçan dhe Klinë.

Për vlerësimin e depove EASH së bashku me Ekspertin Afatgjatë Vendor të Projektit mbi Menaxhimin e Depove dhe O&M ka vizituar Njësitë e Hidrodrinit në Pejë, Deçan, Klinë, Junik dhe Istog. Gjendja e tanishme për sa i përket depos dhe menaxhimit të stotopeve është përshkruar si në vazhdim.

4.2 Procedurat e tanishme të Depos

Një standard i pritur ndërkombëtar i depos është në zbatim në të gjitha pesë Njësitë. Një përshkrim i shkurtër i kësaj procedure mund të përshkruhet kështu:

I gjithë materiali i kërkuar duhet të miratohet nga ana e Menaxherit të Njesisë Operative në Formën e Kërkesës së Materialit. Nëse materiali i kërkuar gjendet në depo, atëherë depoisti e lëshon atë jashtë me anë të formës për Daljen e Materialit. Nëse materiali i kërkuar nuk gjendet në Depo, atëherë Depoisti përgatit një Formë Kërkesë për Blerje të Materialit i cili duhet të blihet dhe ia dorëzon të njëjtën formë Menaxherit të Njesisë Operative për miratim. Ai kontrollon se a është në dispozicion ai material i kërkuar në njësitë e tjera operative ose e drejton at kërkesë në zyrën e prokurimit të Hidrodrinit. Aty, Materiali ose blihet përmes procedurave të prokurimit me tenderim ose blihet në ndonjë dyqan dhe furnizohet depoja e njesisë përkatëse. Pas dorëzimit në depon e njesisë përkatëse materiali regjistrohet nga ana e depoistit në Formën e Hyrjes në Depo dhe Kartelën e Stotopeve.



Të gjitha format (formularët) e nevojshëm janë në dispozicion, por secila njësi është akoma duke përdorur formularin me dizajnin e vet nga e kaluara.

Gjatë Misionit për Menaxhimin e Stoqueve dhe Depove të Programit V të Rehabilitimit të Furnizimit Urban me Ujë, formularët e ri, të bazuar në formularët e ndryshëm të përdorur nga njësitë, ishin zhvilluar së bashku me Hidrodrinin dhe u propozuan që të përdoren në mënyrë gjithëpërfshirëse në të gjitha njësitë. Një shembull i formës së Kërkesës së Materialit në gjuhën Shqipe është paraqitur në Shtojcën 2.

Me përjashtim të Istogut, i cili iu bashkëngjiti së fundmi Hidrodrinit, tash së voni të gjitha njësive iu janë dhënë format e reja të standardizuara nga Zyra Kryesore. Istogu do t'i pranojë format e standardizuara sapo ato të shtypen.

Me përjashtim të Junikut, i cili nuk posedon depon e vet (ujëmatësit në dispozicion janë të vendosur në oborrin e shtëpisë së Menaxherit të Njësisë), të gjitha depot janë në gjendje të mirë fizike. Megjithatë, hapësira deponuese në dispozicion në të gjitha njësitë është tejet e vogël.

Raftet në dispozicion në depot e ndryshme nuk janë të emëruar me numra në mënyrë që të gjendet më lehtë materiali.

Në Pejë, gypat e PVC-së ruhen në një vend të hapur në oborrin e burimit tek kaptazha e Ujit të Zi pa mbulesë apo mbrojtje nga dielli. Nuk është e qartë se nëse këto gypa janë pronë e Hidrodrinit apo e një kontraktori.

Materiali nga të gjitha njësitë regjistrohet në qendër në një bazë të të dhënave (Piano) në zyrën kryesore në Pejë. Regjistrimi i fundit ka filluar së voni (Janar 2007).

4.3 Programi kompjuterik i cili përdoret tani

Hidrodrini është duke përdorur bazën e të të dhënave Piano për faturim, kontabilitet dhe menaxhimin e stoqeve (depos). Këta komponentë mund të përdoren ndarazi ose së bashku.

Pjesa e menaxhimit të stoqeve është duke përdorur metodën "FIFO" (i pari në të parin jashtë) dhe mund të përdoret nën sistemet operative të MSDOS-it dhe Windows-it. Në dukje programi është shumë i thjeshtë mirëpo paraqet informatat e nevojshme.

Një pikë e dobët e programit është që nuk është e mundshme që të shtohen shënimet në krye të dokumentit (headers) e as ato në fund të dokumentit (footers) dhe as të ndryshohet formati i shtypjes. Një shembull, si një foto e marrë nga ekrani është paraqitur në Shtojcën 3.

Piano mund të përdoret përmes rrjetit lokal, por jo përmes Internetit.

Depoisti i njësisë operative të Pejës posedon njohuri themelore mbi përdorimin e programit mirëpo do të ketë nevojë të mëtutjeshëm në rast se programi përdoret për kontabilitetin e depos.

Zyra kryesore në Pejë ka për qëllim që të krijojë baza të të dhënave në të gjitha Njësitë.

4.4 Rekomandimet

Sa më shpejt që të jetë e mundur, në të gjitha pesë njësitë duhet të fillojë përdorimi i formave të reja të shpërndara nga Zyra Kryesore e Pejës.

Përderisa të jetë në përdorim programi Piano për nevojat financiare të Hidrodrinit, regjistrimi i lëvizjeve në depo duhet të vazhdohet që të bëhet në Zyrën Kryesore.

Pas themelimit të bazave të të dhënave nëpër njësi, çdo javë të dhënat e freskuara duhet të dërgohen (përmes Flash memories ose disketës) në Zyrën Kryesore për nevoja të koordinimit. Varësisht nga vëllimi i punës apo materialit që duhet të trajtohet intervalet kohore për dërgimin e të të dhënave mund të shkurtohet apo zgjatet.

Është e nevojshme që të vërtetohet nga ana e Projektit se nëse Gjeloš Gojani nga Hidroing-DK akoma mund të mbajë trajnim për përdoruesit e bazës së të dhënave.

Rafteve në depot e ndryshme duhet tu vihen numra në mënyrë që të lehtësohet gjetja e vendndodhjes së materialeve.

Rekomandohet që të krijohet një objekt i vogël i depos në Junik, e pajisur me materialet e nevojshme për mirëmbajtjen preventive dhe kuruese të p.sh. gypave të materialit dhe diametrit të ndryshëm apo valvulet e ajrit dhe portave etj.

Themelimi i depos rajonale nuk rekomandohet në këtë fazë për arsye të hapësirës së brendshme të kufizuar dhe kohës së gjatë të reagimit në rast të riparimeve emergjente në ndonjërin prej njësive.

Megjithatë, pas zgjerimit të hapësirës së brendshme të depos, materiali tepricë nëpër njësi i cili nuk është i nevojshëm për mirëmbajtje preventive dhe kurative do të duhej që të transferohet në depon në Pejë.

Duhet të kryhen hetime së nëse gypat e PVC-së në depon tek kaptazha e Pejës (Uji i Zi) janë pronësi e Hidrodrinit. Nëse po, atëherë sa më parë që të jetë e mundur ato duhet të mbrohen nga rrezet e diellit, dhe se vendimi për të përdorur atë material në të ardhmen duhet të shqyrtohet me shumë kujdes. Ndërsa, nëse gypat janë pronë e kontraktorit, atëherë duhet të mbahet shumë kujdes që të mos lejohet instalimi i këtyre gypave në asnjërin nga njësitë pasi që gypat tanimë janë dëmtuar.

Eksperti Vendor me Afat të Gjatë duhet t'i asistojë Hidrodrinit në zbatimin e rekomandimeve.

5. Situata ekzistuese në lidhje me O&M Teknike në Njësitë Operative

5.1 Operimi Teknik

Operimet teknike nëpër njësi janë duke u kryer në mënyrë të kënaqshme. Shumica nga stafi operativ kanë një përvojë të gjatë të punës (20 e më shumë vite). Megjithatë, për shkak të vjetërsisë të komponentëve të sistemit në disa raste vështirohet operimi ekonomik.

Në Stacionin e pompave në Pejë, e cila merr ujin nga kaptazha e burimit të Ujit të Zi, dy nga 4 pompat horizontale centrifugale janë 28 vjet të vjetra dhe njëra 18. Gjithashtu në Klinë dhe Istog, disa nga pompat që janë të instaluar dhe që akoma punojnë janë mbi 20 vite të vjetra.

Të dhënat operative regjistrohen nëpër njësitë dhe dërgohen në Zyrën Kryesore në baza mujore në formën e një raporti. Të dhënat përpunohen në kuadër të departamentit teknik të Zyrës Kryesore në Pejë për nevoja dhe qëllime statistikore dhe raportim të caktuar.

5.2 Mirëmbajtja

Me përjashtim të Deçanit dhe Junikut të cilët kanë sistem graviteti (të rënies së lirë), në asnjërin nga njësitë tjera nuk është në funksion ndonjë sistem i mirëmbajtjes preventive. Megjithatë, është thënë në njësitë tjera se kurdoherë që iu lejon koha kryhen aktivitetet e mirëmbajtjes preventive.

Në Deçan, si pjesë e projektit të zbatuar nga Norwegian Church Aid një sistem i mirëmbajtjes preventive ishte zbatuar. Një shembull i Formës së Mirëmbajtjes nga Deçani është paraqitur në Shtojcën 4.

Mirëmbajtja kuruese (punë riparuese) zbatohet në të gjitha njësitë operative. Në Klinë dhe në Pejë 4 riparime kryhen mesatarisht brenda një dite.

Të dhënat e mirëmbajtjes dhe riparimit regjistrohen nëpër njësi dhe ato në baza mujore në formë të një raportimi dërgohen në Zyrën Kryesore. Të dhënat përpunohen në kuadër të departamentit teknik të Zyrës Kryesore në Pejë për nevoja dhe qëllime statistikore dhe raportim të caktuar.

Histori të hollësishme të komponentëve të sistemit për të mbështetur vendimet e menaxhmentit për përmirësime ekonomike të sistemit nuk janë në dispozicion.

Një numër i mjaftueshëm i personelit të kualifikuar teknik për mirëmbajtje është në dispozicion nëpër njësi.

5.3 Rekomandimet

Procedura e mirëmbajtjes si ajo që zbatohet në Deçan është e mjaftueshme dhe gjithashtu duhet të zbatohet në njësitë tjera.

Pasi që format aktuale të mirëmbajtjes në Deçan paraqesin vetëm përshkrimin, lokacionin dhe intervalet kohore për mirëmbajtjen preventive të pajisjeve, ato duhet të rirregullohen nga Eksperti Vendor me Afat të Gjatë me përshkrimin e punës që duhet të bëhet në mënyrë që të sigurohet përputhshmëri e aktiviteteve të mirëmbajtjes.

Prandaj STE ka përgatitur propozimin e ti rreth formave të mirëmbajtjes me ndryshimet e nevojshme në përputhje me komponentët e sistemit në Deçan. Një shembull është paraqitur në Shtojcën 5.

Eksperti Vendor me Afat të Gjatë duhet të diskutojë format e modifikuara të mirëmbajtjes me Njësinë në Deçan dhe nëse arrihet pajtimi, ato të përkthehen në gjuhën Shqipe. Më pastaj, eksperti duhet të vazhdojë më njësitë tjera.

6. Prezantimi

Në fund të detyrës, STE mbajti një prezantim rreth gjetjeve fillestare dhe rekomandimeve. Pjesëmarrës në këtë prezantim ishin Drejtori i Hidrodrinit, Menaxheri Teknik i Hidrodrinit dhe pesë Menaxherët e Njësive Operative si dhe po ashtu Udhëheqësi i Ekipit të Projektit. Pjesëmarrësit nuk konsideruan asnjë nga gjetjet si të pasakta dhe nuk u kundërshtua asnjë nga rekomandimet.

7. Aktivitetet për detyrën e ardhshme

STE do të vlerësojë statusin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në këtë raport të misionit.

Baza e të dhënave të mirëmbajtjes do të sigurohet nga ana e STE për të mundësuar krijimin e historisë së hollësishme të pajisjeve dhe një parashikim rreth aktiviteteve të mirëmbajtjes preventive nëpër njësitë. Personeli teknik i njësive do të trajnohet në përdorimin e bazës së të dhënave.

Nëse arrihet pajtim gjithëpërfshirës rreth formave të mirëmbajtjes, atëherë ato do të kombinohen me në doracak të mirëmbajtjes për secilën njësi.